



PROJEKTI HIDROELEKTRIK I SASAJ *- Pershkrim i shkurter*



Energo - sas
sh.p.k.



Hidrocentrali i SASAJ– pershkrim i shkurter

Hidrocentrali i Sasajt shtrihet ne pjesen Jug - perendimore te vendit buze deti Jon, ne rrugen automobilistike Vlore – Sarande, ne largesi rreth 20 km nga Saranda.

Aksi i Hidrocentralit te Sasajt vendoset ne nje koder ne VP te fshatit Lukove, dhe zhvillohet pergjate proit te Bunecit, ne fagen e orientuar perballe Sasajt.

Ky hidrocentral eshte i tipit me derivacion, ka fuqi te vendosur 8000 kW (2x4000 kW) dhe prodhim mesatar vjetor energjie prej 38 milion kWh, e llogaritur kjo duke zbritur prurjen ne periudhen e ujitjes. Prurja e ujit eshte 3.2 m³/sek dhe rënia llogaritëse 217 m.

Vepra po ndertohet ne vazhdim te vepres se marrjes ne lumin e Kalases, kanalit te derivacionit, tunelit te Sasajt te ndertuar me pare.



Hidrocentrali i Sasajt do te vazhdoje te jete shume funksional pra do te sherbeje per prodhimin e energjise elektrike ne periudhen Tetor – Prill si dhe per ujitje ne periudhen Maj - Shtator.

Veprat e hidrocentralit që po ndërtohen të reja, janë: Komponentet e devijimit (Baseni i Presionit), dhoma e droselit, tubacioni i turbinave, ndërtesa e centralit si dhe levrimi dhe instalimi i te gjitha pajisjeve primare e sekondare te HEC-it.

Lidhja e hidrocentralit me sistemin energjetik te Shqiperise do te behet me linjen ekzistuese 35 kV Sarande - Sasaj, e cila eshte mjaft e amortizuar, per kushtet e dhenies se fuqise se hidrocentralit ne sistem, do te reabilitohet.

PLANIMETRIA E PERGJITHSHME E TUBACIONIT TE TURBINES H.E.C - SASAJ

VOLUMET E PUNIMEVE

SH/ 1: 2 000

DROSELI

$\varnothing=1200$ MM

VOLUMET E PUNES:

200 M³ PUNIME GERMIMI,
3.6 TON HEKUR BETONI,
58 M³ PUNIME BETONI E B/A.

BASENI:

V=10 000 M³

VOLUMET E PUNES:


14 800 M³ PUNIME GERMIMI,
48 TON HEKUR BETONI,
1140 M³ PUNIME BETONI E B/A.

PENSTOCK-U:

L= 1320 M

VOLUMET E PUNES:

770 TON TUBACIONE CELIKU
7400 M³ PUNIME GERMIMI,
3.6 TON HEKUR BETONI,
1600 M³ PUNIME BETONI E B/A.



LEGJENDA

1. KANALI EGZISTUES
2. BASENI I RREGULLIMIT ORAR V= 10 000 M³
3. DHOMA E DROSELIT
4. TUBACIONI I TURBINES $\varnothing 1200$, L= 1320 ML
5. NDERTESA E CENTRALIT (BRENDA RRETHIMIT)
6. KANALI I LARGIMIT L=35 ML
7. NEN/STACIONI ELEKTRIK

$S=3400M^2$

$S=7740M^2$

$S=2350M^2$

$S=210M^2$

8. KULLE T.L (LIDHET ME SISTEMIN)
9. SHESH PER NGRITJE KANTIERI
10. SHESH PER DEPOZIT. PERP. MAT.
11. RRUGE PER NE HEC 350 ML
12. RRUGE PROVIZORE PER NDERTIM
13. KUFIRI I SHESHIT TE NDERTIMIT

$2480 M^2$

$1000 M^2$

$2400 M^2$

$1000 M^2$

$13\ 700 M^2$

	WONDER-STUDIO		OBJEKTI: H.E.C-SASAJ		Faza
	Nr. Licence 3961/H				Pr. Z
	ORIENTOR PROJEKTI	VASIL GJICA	INVESTITORI	ENERGO - SAS	Vitet
	ING. HIDROTEKNIK	STEFAN CEKU	POROSITESI	ENERGO - SAS	2003
	ING. MEKANIK	ALONDO			
	ARK. PERPUNUES	J.SINJAKU	EMERTIMI	PLAN I PERGJITHSHEM	Nr. I flut
	PREVENTIVUES	DI. GJATA	FLETES	TUBACIONI I TURBINES	HC-S 06
	KONTROLLERI	STEFAN CEKU			

Hidrocentrali i SASAJ– Kronologjia e realizimit te projektit

Me Vendim te Qeverise Nr. 634, date 18.09.2003 eshte miratuar fillimi i procedures se Ndertimit me Koncesion te formes "BOO", te Hidrocentralit te Sasajt dhe me Vendimin Nr. 501, Date 23.07.2004 eshte miratuar Marreveshja e Koncesionit per Ndertimin e Hidrocentralit te Sasajt e formes "BOO", lidhur ndermjet METE, si Organ Shteteror i Autorizuar (OSHA), dhe Konsorciumit te shoqerive te projektit te Sasajt.

Me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 35468 date 11.04.2006 u legalizua Shoqeria Koncesionare "ENERGO-SAS" Sh.p.k. e krijuar me 05.09.2004, e cila kryen ndertimin si dhe veprimtarine operatore te Hec Sasaj. Kompania "ENERGO-SAS" eshte shoqeri aksionere ku Kompania AGNA Group zoteron aksionet e veta.


Me Vendim Nr.11/6 date 10.07.2006 te KRRT te Komunes Lukove eshte miratuar destinacioni i Sheshit te Ndertimit per Gjurmen e Hec Sasaj. Eshte marre miratimi i Keshillit te Komunes dhe Komunitetit te banoreve te zones, sipas Akt-Marreveshjes midis banoreve te fshatit Sasaj dhe shoqerise "ENERGO-SAS", te dates 26.11.2008, ku jepet pelqimi i banoreve te ketij komuniteti per ndertimin e hidrocentralit ne tokat e fshatit Sasaj.

Me shkrese Nr.427 Prot. Date 01.08.2007 dhe me vendim nr. 9 te Komisionit te Lejeve eshte akorduar Leja Mjedisore per shoqerine "Energo-Sas" Sh.p.k. per "Ndertim dhe FunkSIONIM Hidrocentrali" nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave.

Me Vendim Nr. 6, date 04.12.2006 eshte miratuar Leja e Perdorimit te Ujit te burimeve te Tatzatit, per Hec Sasaj dhene subjektit "Energo-Sas" Sh.p.k. nga Keshilli i Basenit Ujembledhes "Vjose" Vlore.

Me Vendim Nr. 83 date 27.11.2006 te ERE, eshte dhene Licensa per Ndertimin, Instalimin dhe Prodhimin e Energjise nga Hidrocentrali Sasaj , per subjektin "Energo-Sas" Sh.p.k.

Ne kete menyre ky projekt ka plotesuar te gjithë kuadrin ligjor dhe eshte pajisur me lejen e ndertimit ne janar te vitit 2009 kur kane filluar punimet e ndertimit te vepres.



Hidrocentrali i Sasajt shfrytëzon ujrën e burimeve të Tatzatit, të cilat dalin në pjesën e sipërme të lumit të Kalasës. Pëllgu ujëmbledhës i Kalasës në veprën e marrjes të ndërtuar është 29 km².

Sic shihet nga figura e mesiperme, ujrën e "Tatzatit", merren nëpërmjet kanalit ekzistues dhe tunelit në një distancë prej 6.0 km nga burimi, duke iu afruar tunelit të Sasaj në pikën e quajtur "Kodra e Lapidarit", ku kalojnë teresisht në një terren që i përket fondit të tokave të fshatit SASAJ.

Kuota e kanalit ekzistues (në tabanin e tij) është 222,9 m nga niveli i detit. Gjurma e veprës së re, të HEC Sasaj kalon përgjatë kurrizit të kodrës deri në det, në faqen Veri- Perendimore, nga ana e Sasaj.

Sipërfaqja e territorit të ndërtimit të HEC-it, brenda sheshit të Ndërtimit është 1.37 ha.

Nga puna per ndertimin e Hidrocentralit te SASAJ

Tashme
punimet e ndertimit
te Hidrocentralit te Sasajt kane hyre
ne nje faze shume
te avancuar

Punimet
parashikohen te
perfundojne ne mes
te vitit 2010

Kosto e ndertimit
te vepres parashikohet
te arrije ne rreth
12 mln Euro